

20151524364

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI BOTUESE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtarinë botuese (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 199/14) në nenin 17 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

“(2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligjit bën Ministria e kulturës nëpërmjet inspektorëve për kulturë në pajtim me Ligjin për kulturë.”

Neni 2

Në nenin 18 paragrafi (1) fjalët: “1.000 deri” shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

„(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga gjoba e përlogaritur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.”

Në paragrafin (3) fjalët: “prej 500 deri 1.000” zëvendësohen me fjalët: “prej 100 deri 150”.

Neni 3

Në nenin 19 në paragrafin (1) fjalët: “1.500 deri 3.000” zëvendësohen me fjalët: “2.000”.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

„(2) Gjobë në lartësi prej 30% nga gjoba e përlogaritur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.”

Në paragrafin (3) fjalët: “1.500 deri 3.000” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 300”.

Neni 4

Pas nenit 19 shtohet nen i ri 19-a si vijon:

“Neni 19-a

Përlogaritja e lartësisë së gjobës për personin juridik dhe tregtarin individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”

Neni 5

Pas nenit 20 shtohet nen i ri 20-a si vijon:

“Neni 20-a

(1) Për kundërvajtjet e caktuara në nenet 18 dhe 19 të këtij ligji, inspektoripër kulturë kryerësit të kundërvajtjes do t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën për kundërvajtje, i njëjti duhet ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës për kundërvajtje nga kryerësi i kundërvajtjes regjistrohet në procesverbalin.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) të këtij neni përcaktohet mënyra se si do të mënjahen pasojat e dëmshme të kundërvajtjes, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e kryer.

(4) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën për kundërvajtje e nënshkruan personi përgjegjës ose person i autorizuar nga ai.

(5) Inspektori për kulturë është i obliguar të mbajë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara dhe për rezultatin e procedurave të filluara.

(6) Në evidencën e paragrafit (5) të këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimin, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) të këtij neni ruhen pesë vite nga dita e futjes në evidencën.

(8) Ministri i kulturës përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje.”

Neni 6

Akti nënligjor i caktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.